



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018 ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Agjencinë Kombëtare për Diasporën dhe Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
2. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Elona Hoxha Adnor Shameti, Eglandina Gjermeni, Xhemal Qefalia, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Evis Kushi, Ilir Xhakolli

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti dhe Klotilda Bushka

Të ftuar:

Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën

Dritan Delija - Drejtor i Agjencisë Kombëtare për Diasporën

Soana Jaupllari - Drejtoreshë e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për Diasporës

Mirela Thanasi –Drejtoreshë Finance në Agjencinë Kombëtare për Diasporën

Albana Luca – Drejtoreshë Finance në Fondin Shqiptar të zhvillimit për Diasporën

Yllka Lezo – Këshilltare e Ministrit

Suzana Stefa - Drejtoreshë në Ministrinë e Financave

Xhoana Agolli – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 13 nëntor 2018.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin nën për nën të projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019”.

Të ftuar kemi ministrin Majko.

Faleminderit dhe respekt, zoti Majko, që edhe në parim, edhe nën për nën e prezantoni vetë projektligjin!

Zoti Majko, ne folëm edhe gjatë diskutimit në parim të projektligjit dhe, padyshim, ju komplimentoj për mënyrën e paraqitjes dhe për objektivat që i keni vënë vetes si ministri lidhur me trajtimin e diasporës, mënyrën e përcjelljes së asaj çka është shqiptare deri tek ata nga ana jonë, mbështetjes.

Jemi përpara një momenti të rëndësishëm siç është puna jona e pareshtur për të arritur një ditë që ata të mund të votojnë, të mos humbasin gjuhën dhe sa herë të kthejnë sytë nga shteti amë të ndiejnë mbështetje dhe të rrisin besimin në raport me ne.

Besoj se Agjencia Kombëtare për Diasporën, Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës, ashtu edhe agjencia që do të merret me botimin (më pari dhe më së shumti të librave të mësimi të gjuhës, si abetare e kështu me radhë), janë pjesë e strategjisë suaj të zhvillimit jo vetëm për këtë vit, por edhe në vitet në vazhdim.

Edhe gjatë diskutimit tonë në parim keni paraqitur kërkesën për një rritje të fondit në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në disa zëra. Unë do të doja që ju t’i parashtronit edhe një herë, meqë jemi në diskutimin nën për nën.

E dyta, ashtu siç folëm dje dhe sot, unë do t’ju lutesha që, kërkesa zyrtare pavarësisht paraqitjes që ju keni bërë pranë komisionit tonë dhe transmetimit që unë i kam bërë kryetarit të grupit dhe kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, zotit Braçe, të vijë nëpërmjet ministrit të Financave dhe Ekonomisë në mënyrë që të zyrtarizojmë kërkesën tuaj për ato shtesa fondesh që ju kërkon.

Urdhëroni!

Pandeli Majko - Dëshiroj t’ju falënderoj për gjithë mirëkuptimin që kemi pasur gjatë diskutimit edhe këtu në komision, edhe me ju në veçanti, zonja kryetare.

Ky është buxheti i parë i shtetit, që ka një fond për diasporën dhe është diskutimi i parë për buxhetin e diasporës në Shqipëri. Kemi vetëm disa probleme, të cilat po ua shtjelloj anëtarëve të komisionit shkurtimisht.

Duke qenë se agjencitë apo institucionet përcaktohen nga legjislacioni për diasporën nga një paketë prej 3 ligjesh, që është miratuar nga parlamenti i nderuar gjatë këtyre muajve, ndryshe nga paraqitja në projektbuxhet ajo është paraqitur si një zë për të gjithë buxhetin e 3 institucioneve, përkatësisht, Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrën e Botimeve për Diasporën. Këto janë paraqitur në projektbuxhet me zërin “Shërbime për diasporën”, grupi 87, në të cilin janë parashikuar 83 milionë lekë.

Vërej, dhe kjo është në vlerësimin tuaj, se kjo paraqitje është në kundërshtim me legjislacionin e miratuar, ligji nr.16 “Për diasporën”, ligjin nr.115 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe ligjin nr.32 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Sipas legjislacionit të cituar, këto institucione duhet të jenë me buxhet të ndarë, me zë më vete, sepse Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është institucion publik, nuk është institucion buxhetor, Agjencia Kombëtare për Diasporën është bërë me logjikën e agjencive autonome e kështu me radhë.

Pasi bëra këtë vërejtje, e cila është në vlerësimin tuaj, konstatoj se për Agjencinë Kombëtare të Diasporës në projektbuxhetin e vitit 2019 është propozuar një shumë prej 26 milionë e 500 mijë lekë, por sikur të kihet parasysh se vetëm në strategjinë kombëtare të diasporës, e cila është miratuar edhe nga Ministria e Financave, në faqen nr.51 të kësaj strategjie keni: “Agjencia Kombëtare e Diasporës, 60 milionë lekë për vitin 2018”.

Prandaj mendoj se shifra 26 milionë e 500 mijë është një shifër shumë e vogël. Tani ose do të merremi, ose s’do të merremi. Me këtë gjuhë unë kam folur edhe me ministrin kur është diskutuar buxheti. Qeveria ka disa dokumente strategjike, të cilave duhet t’u qëndroj në mënyrë strikte.

Kërkesat fillestare të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për buxhetin 2019 kanë qenë 165 milionë, por sigurisht, duke pasur parasysh edhe diskutimet, edhe vlerësimet që kemi bërë me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, unë mendoj se buxheti nuk mund të shkojë më shumë se sa gati gjysma, pra rreth 80 milionë, që do të thotë se ne propozojmë të shtohet një vleftë prej 53 milionë lekesh, e ndarë sipas një tablele që unë do t’ua vë në dispozicion.

Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës kemi një problem, përveçse kemi kaluar VKM-në “Për strategjinë kombëtare të diasporës”, ka kaluar një vendim i veçantë qeverie për një program 3-vjeçar, që shënon fillimin e funksionimit të këtij fondi, vendimi i KM-së nr. 611, datë 17.10.2018 “Për financimin e projektit “Diaspora për zhvillim””. Ky program është negociuar qindarkë për qindarkë me ministrinë e Financave.

Mirëpo për vitin 2019 duhet shtuar shuma 14 milionë lekë për të garantuar shumën 44 milionë, që është parashikuar në këtë vendim qeverie.

Po kthehem edhe një herë të Agjencia se lashë diçka pa thënë. Agjencia Kombëtare e Diasporës drejtohet nga këshilli drejtues, ku bën pjesë edhe zëvendësministri i Financave, i cili ka ngritur votën për buxhetin e ministrisë, për shifrën 165 milionë, që unë po ua them tani, që zbriteni dhe bëjeni 80 milionë.

Kam diskutuar edhe ministrin e Financave për rritjen e fondit, kam diskutuar edhe me Kryeministrin në parim dhe kemi rënë dakord që ky buxhet i diasporës duhet të rritet.

Dëshiroj t'u vë në dukje kolegëve fakte, të cilat besoj se flasin më shumë se sa qarja këtu se kemi pak fonde dhe duhet të shtohen edhe disa të tjera.

Për Qendrën e Botimeve të Diasporës në buxhetin e vitit 2019 janë 26 milionë e 500 mijë lekë.

Vetëm këtë vit sistemi që funksionon mes Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Jashtme për shpërndarjen e librit në diasporë është i tillë, vijnë kërkesat nga ambasadat dhe Ministria e Jashtme ia kalon Ministrisë së Arsimit dhe pastaj kjo ia kalon librat Ministrisë së Jashtme, e cila bën shpërndarjen. Pra, është një sistem që mbulohet nga dy ministri më buxhet goxha të konsiderueshëm.

Vetëm këtë vit janë shpërndarë mbi 7500 libra. Të mendosh që ne mund të kemi një fond prej 26 milionë e gjysmë për të furnizuar fëmijët e diasporës dhe të gjithë shkollave që janë hapur, sigurisht jemi duke punuar që kjo punë të mos jetë një çështje teknike, pra po zëvendësojmë një sistem të vjetër me marrëdhënien e dy ministrive që përmenda më lart me një qendër botimesh.

Ndërkaq, paralelisht, në bazë të marrëveshjes midis Ministrisë së Arsimit të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë është miratuar kurrikula e re dhe janë duke u bërë librat bazuar në këtë kurrikul, që do të thotë se të gjithë fëmijët, pavarësisht nga vijnë, do të studiojnë në diasporë me të njëjtat libra.

Qendra e Botimeve të Diasporës akoma nuk është krijuar, pasi në bazë të vendimit të qeverisë për krijimin e saj, ajo duhet të fillojë funksionimin nga data 1 janar 2019. Shuma e kërkuar për këtë qendër është 101 milionë e diçka. Pavarësisht diskutimeve, unë e kuptoj shumë mirë qëndrimin e ministrit të Financave, se është në një pozicion ku të gjithë kërkojnë, por mendoj që të paktën gjysma e kësaj shume do të ishte komode për vitin 2019. Keni parasysh se do të fillojë thajse nga zero. Të gjitha tabelat për propozimet, qoftë për agjencinë, qoftë për fondin dhe për qendrën ne do t'ua vëmë në dispozicion kolegëve të nderuar.

Dëshiroj të nënvizoj edhe një fakt. Ju kam nisur, zonja kryetare, një letër që na e ka drejtuar Ministria e Diasporës së Kosovës. Ata e kanë hequr mënjanë nga buxheti i Kosovës një shumë të caktuar për sa u përket qendrave të kulturës për diasporën.

Në bazë të legjislacionit dhe në bazë të marrëveshjes dypalëshe ne duhet t'i përgjigjemi me të njëjtën shumë për qendrat kulturore të diasporës, sepse çdo shpenzim për qendrat kulturore do të ndahet përgjysmë, kështu që e njëjta shumë duhet vënë edhe te buxheti i Ministrisë së Jashtme. Unë nuk flas në emër të Ministrisë së Jashtme, sigurisht, por mendoj që kolegët duhet ta kenë parasysh. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti ministër!

Unë kam një pyetje: A ka një marrëveshje bilaterale midis Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë lidhur me atë çka thatë?

Pandeli Majko – Ka një marrëveshje ndërshtetërore të firmosur në mbledhjen e përbashkët që u bë në Korçë, midis dy qeverive, është firmosur në nivel kryeministrash, pra edhe për ndarjen e shpenzimeve gjysmë për gjysmë dhe u dedikohet vetëm qendrave kulturore.

Mimi Kodheli – A ka pyetje?

Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Ju thatë se një nga objektivat e punës për vitin 2019 është pajisja me tekste për mësimin e gjuhës shqipe. Doja të dija marrëdhëniet me Ministrinë e Arsimit. A ka ndonjë program kjo ministri lidhur me arsimimin e fëmijëve shqiptarë jashtë?

A keni ndonjë marrëveshje?

Pandeli Majko - Faleminderit!

Për sa i përket arsimimit të fëmijëve jashtë ka filluar një punë, e cila ka nisur që me ndryshimin e projektligjeve “Për arsimin parashkollor dhe “Për arsimin e lartë”.

Siç ju thashë, është bërë marrëveshja me shtetin e Kosovës, e cila ka filluar që në maj të këtij viti të bëhet valide, sidomos për grupin e kurrikulës. Pasi është rënë dakord për kurrikulen e re për arsimin në diasporë, grupet e punës janë duke punuar për librat përkatës.

Për sa i përket arsimimit, në bazë të ndryshimeve të legjislacionit ne kemi ngritur një grup të përbashkët pune me Ministrinë e Arsimit për të bërë të gjitha aktet nënligjore që kanë të bëjnë me ndryshimet ligjore dhe që kanë të bëjnë së pari me mënyrën e certifikimit të mësuesve që japin mësim në diasporë për krimin e një regjistri zyrtar që është cituar edhe në ndryshimet ligjore që i ka kaluar parlamenti dhe që kanë të bëjnë me krimin e një regjistri zyrtar për mësuesit që japin mësim në diasporë.

Gjithashtu, do të miratohet edhe certifikata, e cila do të firmoset nga dy ministrat e Arsimit, të Kosovës dhe të Shqipërisë dhe do t'u shpërndahet fëmijëve, të cilët do të mbarojnë studimet mbi bazën e kurrikulës së re.

Pra, ne do të shkëputemi nga skema e vjetër. Kur flas për kurrikulen e re, flas për kurrikulën e fëmijëve në diasporë, në emigracion, kudo ku janë, në Greqi, në Itali, në Amerikë, në Australi, pra kudo do të ketë vetëm një kurrikul dhe do të jepet një certifikatë.

Ne po punojmë me dy projekte. Janë disa gjëra, të cilat duhen filluar të ridiskutohen edhe nga pikëpamja teknike, mësuesit, certifikatat, valiteti i tyre në sistemin arsimor të vendeve pritëse e kështu me radhë.

Për sa i përket shpërndarjes së librave ne po shikojmë edhe projekte të librit dixhital. Jemi një ndër shtetet që kemi një numër të madh bashkatdhetarësh jashtë vendit dhe jemi ndër më të varfrit për sa i përket librit online.

Ajo që ne kërkojmë, nuk është të qahemi për atë që kemi gjetur, por të kërkojmë mekanizma dhe besoj se krijimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën do të merret edhe me këtë. Fakti që me ligj parlamenti ka vendosur ta specifikojë të gjithë strukturën që do të merret me diasporën, që ka të bëjë me agjencinë, me fondin dhe me qendrën tregon se në vazhdim do të kemi një ushtrim autoriteti dhe një specifikim të marrëdhënies së shtetit me këtë shtresë të popullsisë.

Mimi Kodheli – Urdhëro, Adnor!

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të parë më lejoni të shpreh vlerësimin më të madh për punën njëvjeçare të Ministrisë së Shtetit për Diasporën, për strukturën e ngritur, për projektet e krijuara e në këtë kuptim, besoj se të gjithë anëtarët e këtij komisioni të nderuar duhet të mbështesin me ç'është e mundur edhe të presojmë sa më fort te Ministria e Financave që në rakordimet përfundimtare të buxhetit të bëjmë të mundur përmbushjet të të gjitha atyre gjetjeve dhe kërkimeve që ka planifikuar Ministria për Diasporën për këtë buxhet, që është shumë modest, por që si vit i parë efektiv i kësaj ministrie të bëjë të mundur realizimin e objektivave dhe pritshmërive kryesore të atyre shtyllave të veprimtarisë së këtij institucioni.

Në këtë kuptim nuk më ngelet gjë tjetër veçse t'ju ftoj të gjithëve të bëjmë ç'është e mundur për ta kaluar dhe për t'ia përcjellë Ministrisë së Financave, ashtu sikurse ministri Majko e paraqiti në këtë komision. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shameti!

Nëse nuk ka pyetje ose diskutime, unë mendoj se kërkesat që vijnë nga Ministria e Shtetit për Diasporën janë të drejta në përmbushje, jo vetëm të strategjisë tashmë të miratuar,

por edhe të detyrimit tonë të kahershëm për të mbështetur maksimalisht qytetarët shqiptarë jashtë trojeve të Shqipërisë dhe jo vetëm ata, por edhe ata që kanë lindur prej gjak shqiptari, apo që banojnë në ato treva prej shumë kohësh.

Kështu që jam dakord edhe me atë që zoti Majko sapo tha, lidhur me ndarjen e shpenzimeve për qendrat që do të organizohen jashtë kufijve tanë, ku shteti i Kosovës do të marrë pjesë aktivisht.

Nuk me mbetet asgjë tjetër, veçse të mund të tejçojmë në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave kërkesat tuaja, por, nga ana tjetër, do t'ju lutesha që këto kërkesa, me ndryshimet respektive mund të vijnë, atë që, me të drejtë, tha zoti Shameti, në draftbuxhetin përfundimtar, i cili do të diskutohet në parim më datën 22 dhe nën për nen me datën 3 dhjetor në mënyrë që llogaritë e shtetit të mund të rakordohen.

Unë do t'ju ftoja, zoti Ministër, që edhe ju, përtej gjithë punës që keni bërë, edhe presionin që keni bërë mbi ministrin Ahmetaj, të mundësoni një zyrtarizim të ndryshimeve që kërkon.

E ripërsëris se e kam diskutuar dje me kryetarin Braçe, ashtu edhe me kryetarin e grupit Balla, atë çka ju kërkon dhe nga të dyja anët besoj se do të ketë një presion pozitiv në mënyrë që të arrijmë atje ku duam.

Ju ftoj ta miratojmë me propozimet që ministri ka kërkuar dhe më pas të mundësojmë një realizim final të këtyre ndryshimeve, meqenëse po flasim për shuma që krahasimisht me sektorët e tjerë janë shuma relativisht modeste, duke relativizuar shifrën.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Faleminderit!

Miratohet.

Faleminderit, ministër për prezencën!

Punë të mbarë!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA